- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34

Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35

Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-2233-5-2-1/C709

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muaj Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës me shkrim nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është do të caktohen me vendim të ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 1 vit nga përfundimi i punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.



NDËRTIMI I ANEKSEVE PËR KALLDATORE NË SHFMU "Ali Hasi" & "Dëshmorët e Kombit"


1. Shkolla "Ali Hasi" Cërmjan

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLUESE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.01.01	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndërtimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	40.00 €	40.00 €
1.01.02	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2m në tërë perimetrin e caktuar të punishtës dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilit e hekurit dhe llarina.	m ²	40	1.00 €	40.00 €
1.01.03	Demolimi dhe eliminimi i të gjitha pengesave dhe objekteve në parcellën ndërtimore, në tërë sipërfaqen ku do të ndërtohet objekti i aneksit dhe transportimi i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna deri 10km distance. Këtu përfshihen shigjet nga betoni, gjelberimi dhe materiale të tjera që mund të hasen në parcellën ku është parapare të ndërtohet aneksi.	komplet	1	27.00 €	27.00 €
1.01.04	Te behet demontimi dhe zhvendosja e radiatorëve në hapsirën e koridorit të shkollës ekzistuese aty ku do të behet hapja e detyrës për kalim në aneks në perdhese dhe në kat. Në cmim përfshihen vazhdimi i gypave, lidhësve dhe paisjeve tjera fazonike. Pozicionimi i radiatorëve do të behet në koordinim me organin mbikqyes.	cope	2	49.00 €	98.00 €
1.01.05	Perja, demolimi i pjesës së murit të jashtëm për nevojë të krijimit të hapjeve për dyer (kalimi nga shkolla në aneksin që do të ndërtohet), transportimi i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna. Vërejtje: Hapja në perdhese do të ketë dim. 180x210 cm, ndërsa hapja në katin 1 do të ketë dim. 100x210 cm, siç është parapare në projekt.	m ²	3.40	15.00 €	51.00 €
1.01.06	Te behet demolimi i dritareve nga PVC me dimensione 190x125 cm sipas planit të demolimeve tek pjesa grafike e projektit. Në cmim përfshihet demontimi i gureve të parapetit si dhe pikoreve të jashtme nga llarina dhe transporti i mbeturinave në deponinë e caktuar nga komuna deri në 10 km distance.	cope	10	2.00 €	20.00 €
1.01.07	Te behet demontimi i ullukut vertikal tek pjesa e ku do të ndërtohet aneksi i shkollës. Në cmim përfshihet ripërpunimi i tij dhe pershtatja për zbrazjen e ujërave atmosferik në kulmin e aneksit të ndërtuar.	cope	1	5.00 €	5.00 €
1.01.08	Punë të ndryshme të paparapara gjat fazës së demolimeve të cilat nuk janë mundur të llogariten apo në rast të ndonjë demtimi eventual. Të llogaritet në total maksimum 5% e shumës nga Pos 1.01.03 deri 1.01.07	%	0.05	201.00	10.05
TOTAL POZICIONI				1.01	291.05 €

1.02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit me trashësi 30 cm në tërë sipërfaqen e parapare për pozicionimin e objektit, shigjetëve. Në cmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m ³	20.00	5.00 €	100.00 €

1.02.02	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë deri në 105 cm thellësi (kuota -1.35 nga nga niveli i tokës) për hapjen e kanaleve për themelet shiritore të objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkëmbjes.	m ³	23.50	7.50 €	176.25 €
1.02.03	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 për themelet shiritore në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura si dhe pjesës nën pllaken e perdhës duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. Vërejtje: Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%.	m ³	4.50	14.00 €	63.00 €
1.02.04	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 20 cm me fraksion 0/63 për themelet shiritore në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura si dhe pjesës nën pllaken e perdhës duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. Vërejtje: Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%.	m ³	11.40	14.00 €	159.60 €
1.02.05	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë mureve të themeleve si dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 25 cm me fraksion 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë MS=30 MPa. Vërejtje: Mbushja të realizohet pas betonimit të mureve të themeleve perimetrike deri në kuotën -0.30 për tërë gabaritin e objektit dhe pas veshjes së anës së brendshme me termoizolim XPS si në detal.	m ³	16.00	14.00 €	224.00 €
TOTAL POZICIONI			1.02	722.85 €	

1.03 PUNËT E BETONIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSIA me tvsh	SHUMA totale me tvsh
VËREJTJE 1:					
1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së themeleve perimetrike shiritore. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e shputës së themeleve.	m ³	1.10	40.00 €	44.00 €
1.03.02	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së pllakës së përdhës. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Betonimi do të realizohet në dy faza para dhe pas punimit të hidroizolimit.	m ³	2.50	40.00 €	100.00 €
1.03.03	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve perimetrike shiritore me gjërsi 60 cm dhe lartësi 165 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arrijtjen e padepërtueshmërisë nga uji si llojet Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	13.20	80.00 €	1,056.00 €
1.03.04	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së përdhës në kuotën ± 0.00 me trashësi 20cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	6.10	80.00 €	488.00 €
1.03.05	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave të përdhës dhe katit me dimensione 25x40 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	2.60	80.00 €	208.00 €
1.03.06	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së katit dhe kulmit me trashësi 20 cm duke përfshirë edhe trarët perimetrik dhe konzollat në të gjitha anët. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	12.50	80.00 €	1,000.00 €



1.03.07	Furnizimi me material dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer) me dimensione 12x20 cm dhe 25x20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	0.30	100.00 €	30.00 €
1.03.08	Furnizimi me material dhe betonimi i shkallëve tek hyrja në objekt në nivelin e përdhësës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Pozicionet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokë/zhavor të pavarura nga themelet dhe cokla e objektit. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	0.70	100.00 €	70.00 €
TOTAL POZICIONI			1.03	2,996.00 €	

1.04 PUNËT E ARMIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totali me tvsh
1.04.01	Furnizimi me material, preja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
	Ø8, Ø10, Ø12, Rrjetë Q-335	kg	3,525.60	0.96 €	3,384.58 €
TOTAL POZICIONI			1.04	3,384.58 €	

1.05 PUNËT E MURATIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totali me tvsh
1.05.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 cm blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMali" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m ³	12.00	65.00 €	780.00 €
1.05.02	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 20 cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMali" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim. Në çmim përfshihet dhe muratimi i mureve të atijes në fete perimetrit të objektit.	m ³	6.60	65.00 €	429.00 €
TOTAL POZICIONI			1.05	1,209.00 €	

1.06 PUNËT E SUVATIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.06.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i plafoneve dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e plafonit në kthinën në përdhësë dhe kat dhe murit të shkollës nga ana veriore me material/llaq të parapëzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaq sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit vetngjitës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folie të PVC-së si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaqit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m ²	300.60	5.90 €	1,773.54 €
1.06.02	Furnizimi me material dhe finalizimi i mureve dhe plafoneve të kthinës teknike në përdhësë me llaq finalizues të hollë të parapëzier me strukturë (gëlqere + çimento + agregat + imët) RÖFIX 325 ose material i ngjashëm me trashësi 2 mm.	m ²	98.60	4.00 €	394.40 €
1.06.03	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve dhe plafonit me dy shtresa glet-masë (secila me trashësi së paku 1 mm) RÖFIX 225 ose material të ngjashëm në kat.	m ²	82.00	3.00 €	246.00 €
TOTAL POZICIONI			1.06	2,413.94 €	



1.07 PUNËT E NGJYROSJES					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të patinuara me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit si StoColor Puran. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyeje bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	82.00	1.00 €	82.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve të suvuara me llaç dhe murit të shkolles, me strukturë me dy shtresa ngjyrë StoColor In. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Ngjyra StoColor In aplikohet për hapësirat teknike, depo të, garazhën etj.	m ²	218.60	1.00 €	218.60 €
TOTAL POZICIONI				1.07	300.60 €

1.08 PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMËSË					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.08.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha kthinat e brendshme në perdhese dhe kat me dyshe me pllakat qeramike duke përfshirë shtresën ndarëse. Në çmim të përfshihet realizimi i nivelizimit me shtresat si në vijim: • Estrih me trashësi 5 cm • Folie/nënshtrësë alumini për ngrohje gypore në dyshe me • Austrotherm EPS® A100 termoizolim me trashësi 3 cm • Austrotherm EPS® T650 izolim akustik me trashësi 2 cm	m ²	53.00	25.00 €	1,325.00 €
1.08.02	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit dhe termoizolimit të nënkulmit mbi tërë sipërfaqen e pllakës së fundit. Në çmim të përfshihet realizimi i nivelizimit dhe termoizolimit me shtresat si në vijim: • Estrih me trashësi 5 cm • Folie PE • Austrotherm EPS® A120 termoizolim me trashësi 10 cm (5+5cm për shmangien/mbulimin e fugave) • Rrëzë e imët për rrasthim/nivelim sipas nevojës	m ²	27.00	12.00 €	324.00 €
TOTAL POZICIONI				1.08	1,649.00 €

1.09 PUNËT E HIDROIZOLIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.09.01	Furnizimi me material dhe hidroizolim i komplet dyshemesë në katin perdhese me hidroizolim (trakë bituminoze). Për këtë duhet të përdoret hidroizolimi Knauf 3mm, Kondor-3 ose Index-3mm dhe lyeja paraprake e bazës me Bitolit. Për më shumë të dhëna reth mënyrës së aplikimit shih standardin EN 13969-2004, EN13969:2004/A1:2004 Tip A dhe përshkrimin teknik.	m ²	35.00	12.00 €	420.00 €
TOTAL POZICIONI				1.09	420.00 €

1.10 PUNËT E QERAMIKËS GRANITIT KUARCIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totale me tvsh
1.10.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë e kthinave të brendshme në perdhese dhe kat me pllaka të paglazura qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuar nga organi mbikqyrës në koordinim me shfytëzuesit/përfutuesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaleve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	53.00	22.50 €	1,192.50 €



1.10.02	Furnizimi me material dhe punimi i çokllës me lartësi 10 cm tek hapësirat me mure të suvatuara në kthinat në perdhese dhe kat me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ¹	42.20	23.00 €	970.60 €
1.10.03	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme tek hyrjet në objekt, me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë të përpunuar me flakë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale edhe pjesët anësore të shkallëve (së paku 20 cm në nivelin e kubëzave) duke përfshirë çokllën me lartësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën termoizoluese. Ngjytja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min. 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	8.00	26.00 €	208.00 €
1.10.04	Furnizimi me material dhe ngjytja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjytës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gahendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdimë). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm. Gjerësia (së paku 2 cm duhet të dalin jashtë murit) Ngjyra e bardhë	m ¹	10.80	46.00 €	496.80 €
TOTAL POZICIONI			1.10	2,867.90 €	

1.11 PUNËT E ZDRUKHTARISË DYERT DHE DRITARET					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA totali me tvsh
1.11.01	Furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve sipas specifikimeve në projekt.				
a.	POS D01 Derë njëkrahëshe. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik. Dimensionet: 100x210 cm Dukja si në skemën në Z.01	copë	2.00	185.00 €	370.00 €
b.	POS D01 Derë dykrahëshe. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik. Dimensionet: 180x210 cm Dukja si në skemën në Z.02	copë	1.00	410.00 €	410.00 €
c.	POS W01 Dritare katërkrahëshe me hapje kiper. Dimensionet: 425x80 cm Dukja si në skemën në Z.03	copë	1.00	280.00 €	280.00 €
d.	POS W02 Dritare njëkrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 125x190 cm Dukja si në skemën në Z.04	copë	5.00	200.00 €	1,000.00 €
TOTAL POZICIONI			1.11	2,060.00 €	

1.12 PUNËT E FASADËS					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me tvsh	SHUMA totali me tvsh



1.12.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër i ngjashëm i prodhuesve tjerë. Sistemi StoTherm Vario duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Ngjitës StoLevell Uni • Termoizolim Austrotherm EPS AF - t=10cm • Rrjetë Armimi Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoLevell Uni • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Llaç struktural organik Stoispolit Kratz K 2.0 mm • Ngjyrë vetpastruese StoLotusan Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, listelat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m²	97.5	24.00 €	2.340.00 €
1.12.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës dekorative nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Coklla termoizoluese duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë StoPrep Contact • Ngjitës - masë hidroizoluese StoFlexyl • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoFlexyl • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Llaç dekorativ shumëngjyrësh StoSuperlit K 2.0 mm Coklla duhet të realizohet nga kuota - 15.0 deri në kuotën -0.45 ose deri në 10 cm thellësi në nivelin e trotuarit të përfunduar për të shmangur ekspozimin nga uljet e mundshme të trotuarit. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues. Vërejtje: Shtresa termoizoluese është e përfshirë te punët termoizoluese si pjesë e një tërësie më të madhe.	m²	5.9	20.00 €	118.00 €
